



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:004419

Datë: 10.10.2024

Numri i dokumentit: 06280534

Ac.nr.2655/2022

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ardian Ajvazi - kryetar i kolegjit, Lumni Sallauka dhe Hunaida Pasuli - anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit F.A. nga Gj., përfaqësuar nga A. K.avokat nga P. , me adresë xxxx, kundër të paditurit Spitali i Përgjithshëm “Isa Grezda “ Gjakovë, rr .”Dëshmorët e Lirisë”, përfaqësuar nga e autorizuar V. R., kontest pune- pagesë e shpërblimeve jubilarë, vlera e kontestit 554.50 euro, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës të parashtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë, Departamenti i Përgjithshëm C.nr.36/21, të datës 08.02.2022 në seancën e kolegjit të mbajtur më 10.10.2024 nxjerr këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e të paditurës Spitali i Përgjithshëm “Isa Grezda në Gjakovë, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë, Departamenti i Përgjithshëm C.nr.36/21, i datës 08.02.2022, VËRTETOHET.

A r s y e t i m i

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar C.nr.36/21 të datës 08.02.2022, ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit F. A. nga Gj. dhe ka detyruar të paditurën Spitali i Përgjithshëm “Isa Grezda” Gjakovë, që në emër të pagesës së shpërblimit jubilar për 11 vite të përvojës së punës, t’ia paguaj në emër të një page shumë prej 554.50 euro (pesëqindpesëdhjetë e katër euro e pesëdhjetë cent), me kamatë ligjore prej 8%, e cila do të llogaritet nga data 25 nëntor 2021, e gjerë në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 300.80euro (treqind euro e tetëdhjetë cent), të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor, ankesë ka paraqitur pala e paditur, për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovojë ankesën si të bazuar, ashtu që ta hudh posht kërkesëpadinë e paditësit.

Paditësi nuk ka parashtruar përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se

Ankesa e të paditurës është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi F. A., përmes përfaqësuesit të autorizuar, A. K.-avokat nga P., me datë 08.01.2021, ka ushtruar padi kundër të paditurës me kërkesë kompensimi në emër të shpërblimit jubilar. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar shumën 20.00 euro për taksë gjyqësore, për përpilim të padisë shumën prej 78.00 euro, si dhe për përfaqësim në dy seancë 101.40 euro.

E paditura, në përgjigje në padi kundërshton në tërësi pretendimet e paditësit. Bazuar në nenin 4 pika 3 e Kontratës Kolektive Sektoriale përfitues të beneficioneve të cilat dalin nga kjo marrëveshje dhe të cilat bazohen në Ligjin e Punës janë të gjithë punëtorët shëndetësor, ndërsa beneficionet/dobitë që dalin nga marrëveshjet e që nuk janë pjesë e Ligjit të punës i gëzojnë vetëm anëtarët e FSSHK-së. Pas shqimit të listës së pagës së paditësit është verifikuar se i njëjti nuk është anëtarë i FSSHK-së dhe ka propozuar që kërkesë padia e paditësit të refuzohet si e pabazuar. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë, ka mbajtur shqyrtim gjyqësor dhe pas administrimit të provave të prezantuara nga palët ndërgjyqëse ka nxjerrë aktgjykim e atakuar C.nr.36/21 të datës 08.02.2022 me të cilin e aprovuar kërkesëpadinë e paditësit duke vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

Në arsyetimin e këtij aktgjykimi, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se nuk është kontestues fakti se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura në pozitë infermier në Shërbimin e Emergjencës. Nga vërtetimi i marrëdhënies së punës dhe Lista e pagave e lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, e cila i referohet muajit janar 2021 vërtetohet se paditësi ka përvojë pune mbi 10 vite dhe realizon pagë neto mujore në lartësi prej 704.50 euro. Në fund, gjykata e aprovoj kërkesëpadinë e paditësit duke e mbështet vendimin e saj në nenin 17, paragrafi 3 pika 3.1 të Kontratës Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë (KKS) dhe nenit 245 të LMD-së. Për sa i përket llogaritjes së kamatës ligjore vendosi sipas nenit 382 të LMD-së, ndërsa për shpenzimet e procedurës vendosi sipas nenit 452 paragrafi 1 I LPK-së.

Gjykata e Apelit e aprovon në tërësi vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm sa i përket vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, për arsye se i njëjti nuk ka konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, të pretenduara dhe as në shkeljet nga neni 182 par.2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, dhe rrjedhimisht nuk ka aplikim të gabuar të drejtës materiale për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditurës për konstatimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, ngase gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë së paditësit, e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar të gjitha faktet, prandaj gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe faktet vendimtare si marrëdhënia e punës si dhe përvoja e punës së paditësit tek e paditura nuk kanë qenë kontestuese.

Me dispozitat e nenit 90 paragrafi 1 të Ligjit të Punës 03/L-212, të datës 01.11.2010, përcaktohet se: *“Marrëveshja Kolektive mund të lidhet në mes: a) organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij, dhe b) organizatës së të punësuarve, ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve”*. Me paragrafin 2 të këtij neni përcaktohet se Marrëveshja Kolektive mund të lidhet a) në nivel të vendit, b) në nivel të degës dhe c) nivel të ndërmarrjes. Me paragrafin 3 të këtij neni përcaktohet se *“Marrëveshja Kolektive duhet të jetë në formë të shkruar, në gjuhën zyrtare të Republikës së Kosovës”*. Me paragrafin 3 përcaktohet se *“Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me marrëveshjen e tillë kolektive”*. Paragrafi 4 përcakton se *“Marrëveshja Kolektive mund të lidhet për një periudhë të caktuar me kohëzgjatje jo më shumë se tri (3) vjet”*, ndërsa paragrafi 5 thekson se *“Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive”*.

Po ashtu me nenin 17, paragrafin 3, të Kontratës Kolektive Sektoriale, e cila ka hyrë në fuqi me datën 11.06.2018, përcaktohet se *“Punëtorët shëndetësor, në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënësi i fundit në vlerë: 3.1. Për 10 vjet të përvojës në punë në institucione shëndetësore, në vlerë të një page mujore të tij; 3.2. Për 20 vjet të përvojës në punë në institucione shëndetësore, në vlerë të dy paga mujore të tij...ndërsa neni 17 paragrafi 4 i Kontratës Kolektive Sektoriale parasheh se: “Punëdhënësi i fundit është ai që paguan shpërblime jubilarë”. Shpërblimi jubilar, paguhet në afat prej një muaji, pas plotësimit të kushteve nga ky paragraf”*. Andaj mbi bazën e të lartcekurave, kjo gjykatë gjeti se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur kur e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar në tërësi, për çka edhe vendosi që të njëjtin ta vërtetoj sikurse në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Nuk qëndron as pretendimi ankimor i të paditurës se Kontrata Kolektive Sektoriale nuk është obligative për të paditurën, për arsye se nuk është nënshkruese e saj ngase referuar dispozitave të Kontratës Kolektive Sektoriale, rrjedhë se obligimi për përmbushjen e të drejtave të punësuarve të parapara me këtë Kontratë, i takojnë pikërisht punëdhënësit, që në rastin konkret i bie të jetë e paditura. Në këtë pikëpamje, çfarëdo vështirësie që i atribuohet implikimeve financiare lidhur me zbatimin e kësaj kontrate, nuk e liron të paditurën nga përgjegjësia për përmbushjen e obligimit në raport me kërkesën e paditëses gjegjësisht nuk paraqet bazë që kërkesëpadia të trajtohet si e pa themeltë.

Gjykata e Apelit vlerëson se, në rastin konkret është obligim i të gjitha institucionet shëndetësore të zbatojnë këtë kontratë, pasi që e njëjta është nënshkruar nga Qeveria e Republikës së Kosovës-Ministria e Shëndetësisë dhe Federata e Sindikatave të Shëndetësisë së

Kosovës, prej së cilës rrjedhin detyrime të cilat është e obliguar e paditura t'i përmbush, gjegjësisht përgjegjësia për kompensimin e shpërblimit jubilar dhe të drejtat tjera të cilat u përkasin punonjësve shëndetësor ku sipas nenit 4 paragrafi 1, paragrafi 2, paragrafi 3 dhe paragrafi 4 të Kontratës Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë të datës 11.06.2018, ndër të tjera thuhet se: *“KKS-ja gjen zbatim në rregullimin e raporteve juridike për të gjithë të punësuarit nëpër institucione shëndetësore, duke përfshirë tri nivelet e sistemit shëndetësor, atë parësor, dytësor dhe tretësor. Fushë zbatimi i KKS-së, ushtron efekt tek punëtorët shëndetësor deh administrativ në institucione shëndetësore”, ndaj detyrimi për zbatimin e kësaj kontrate ka fuqinë ligjore. Përfitues të beneficioneve të cilat dalin nga kjo marrëveshje dhe të cilat bazohen në Ligjin e Punës janë të gjithë punëtorët shëndetësor, ndërsa beneficionet/dobitë që dalin nga marrëveshjet e që nuk janë pjesë e Ligjit të Punës i gëzojnë vetëm anëtarët FSSHK-së.*

Prandaj, thëniet e të paditurës se kërkesëpadia duhet refuzuar, nga shkak se nënshkruesit e marrëveshjes nuk ia kanë siguruar të paditurës mjetet për buxhet për pagesë nuk janë të bazuara, duke marrë parasysh se ky shkak i cili do ta lironte të paditurën nga përgjegjësia, nuk është paraparë as me dispozitat e ligjit e as të kontratës kolektive, e as përfaqësuesi i të paditurit nuk ka provuar në ndonjë mënyrë tjetër se thëniet e tij janë të bazuara.

Gjykata me rastin e aplikimit të kamatës ligjore, iu referua nenit 382, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit për Marrëdhëniet Detyrimeve Nr.04/L-077, në të cilën parashihet se *“Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën, ndërsa në par.2 të së njëjtit nen parashihet “Lartësia e kamatëvonesës është 8% në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë”.*

Në të njëjtën kohë, gjykata e shkallës së parë drejtë i ka llogaritur dhe i ka pranuar paditëses edhe shpenzimet e procedurës në këtë çështje kontestimore, duke u bazuar në dispozitat ligjore të nenit 452 të LPK-së.

Gjykata e Apelit i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, porse të njëjtat gjeti se nuk janë me ndikim në vendosje ndryshe nga kjo gjykatë andaj të njëjtat edhe i refuzoi të pa bazuara.

Prandaj, Gjykata e Apelit, mbi bazën e të lartë cekurave, u në bazë të nenit 195.1 pika d) lidhur me nenin 200 të LPK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.2655/2022, datë 10.10.2024

Kryetari i kolegjit-Gjyqtari,
Ardian Ajvazi